



Nr.4

ISSN 2521-831X

BULETINI MUJOR

KLIMATIK

Prill 2017



Universiteti Politeknik i Tiranës

Instituti i Gjeoshkencave, Energjisë, Ujit & Mjedisit

Tirana © 2017



BULETINI MUJOR

KLIMATIK

Muaji: Prill Viti 2017

Nr. 4

Vlerësimi meteorologjik për muajin prill 2017

Muaji prill u karakterizua me mot të qëndrueshëm në pjesën më të madhe të kohës. Paqëndrueshmëritë më të theksuara u vrojtuan kryesisht në mesin e muajit, ndikuar nga prania e një sistem ciklonar si dhe në fund të tij. Gjatë këtyre ditëve u vrojtuan dhe reshje shiu e dëbore në lartësi. Siç pasqyrohet dhe në grafikët në vijim në pjesën më të madhe të vendit u vrojtuan 7-12 ditë me reshje, por gjithsesi vlerat e tyre në përgjithësi shënuan deri në 65% të vlerave të normës.





Figura Nr. 1. Pasqyron një pamje tipike të situatës sinoptike mbizotëruese gjatë këtij muaji (datë 5 prill 2017).

Karakteristikë vijon të ngelet për muajin prill fakti që temperaturat e ajrit vijnë të ruajnë vlera më të larta se norma, gjë që qartësisht paraqitet dhe në grafikun e figurës Nr.2.


Figura Nr. 2. Paraqitje grafike e temperaturave të ajrit për muajin prill për vendmatjen meteorologjike të Tiranës për vitet 2012-2017 dhe vlerat e normës referuar periudhës 1961-1990.



Për një informacion më të detajuar ditor mund të konsultoni dhe

Buletin Ditor Meteorologjik të përgatitur nga Departamenti i Klimës dhe Mjedisit të IGJEUM.


Vlerësime për ecurinë e temperaturës së ajrit dhe reshjet në disa prej vendmatjeve meteorologjike të **Sistemit Kombëtar të Monitorimit Meteorologjik** për muajin prill 2017.




KARAKTERISTIKAT KRYESORE KLIMATIKE TË MUAJIT: PRILL 2017

Bazuar në të dhënat e muajit prill 2017 dhe krahasuar me të dhënat e normës klimatike (referuar periudhës 1961-1990) u mundësuan disa vlerësime në lidhje me ecurinë e temperaturës së ajrit dhe reshjet. Vlerësimet në vijim kanë rëndësi për të kuptuar më mirë dhe se si po reflektohen ndryshimet klimatike në vendin tonë.

TEMPERATURA E AJRIT - Për muajin prill 2017 temperaturat e ajrit vijuan të ruajnë në përgjithësi në shumicën e vendmatjeve meteorologjike temperatura rreth 0.5°C deri 2.5°C më të larta se norma, për shkak të pranisë së masave ajrore më të ngrohta dhe një qëndrueshmërie atmosferike me një kohëzgjatje më të madhe. Kjo dukuri, pasqyrohet dukshëm dhe në grafikun në vijim me të dhënat për 22 vendmatjet meteorologjike të shtrira në të gjithë territorin e vendit tonë. Gjithashtu karakteristikë tjetër ishte prania e amplitudave më të larta se norma me rreth 1.5°C.




RESHJET ATMOSFERIKE - Sa i takon reshjeve atmosferike u regjistruan vlera më të ulta se norma në shumicën e vendmatjeve meteorologjike në territorin e vendit tonë. Në tërësi ato arritën deri në 65% të vlerave të normës. Vetëm në disa vendmatje u shënuan vlera pranë normës, siç ishin ato të Krujës 107%, Kuçit 113%, dhe Petrelës 101%, ndërkohë vlera më e lartë mbi normë u shënuar në Shishtavec 123.8 mm ose 179%. Në grafikun në vijim jepet një pasqyrë më e plotë për ecurinë e reshjeve në 26 vendmatjet meteorologjike të shtrira në të gjithë territorin e vendit tonë të përzgjedhura nga të dhënat e 29 vendmatjeve të përpunuara. Reshje të larta u regjistruan në Korthpulë 334 mm, një vendmatje që është ngritur dhe funksionon pas periudhës që i referohet norma, në Vrith 194.5 mm dhe në Macukull 126.7 mm. Ndërkohë, në Pukë dhe në Narel u vrojtuan dhe reshje të pakta dëbore, përkatësisht 2 dhe 4 cm në datat 18 e 19 prill 2017.




VLERËSIME MBI SITUATËN METEOROLOGJIKE TË PRITSHME PËR MUAJT NË VIJIM.

TEMPERATURA E AJRIT - Parashikimi sezonal për periudhën tremujore në vijim: qershor, korrik, gusht 2017; evidenton një situatë të pritshme me temperatura mesatare të ajrit mbi normë me rreth 2°C edhe për territorin e vendit tonë.



RESHJET ATMOSFERIKE - Ky sistem i parashikimit sezonal probabilitar të reshjeve bazohet në vlerësime të plota të shpërndarjes së probabiliteteve. Parashikimi probabilitar stinor përgatitet prej rezultateve të marra nga aplikimi i një tërësie modelesh. Nëpërmjet përdorimit të rikalibrimeve statistikore dhe bazuar në performancën historike të këtyre modeleve mundësohen informacione të vlefshme për një sërë përdoruesish, të interesuar si për vlerësimin e riskut klimatik apo vendimmarrje të caktuara, ashtu dhe për komunitetin e vetë parashikuesve të fushës meteorologjike.





INFORMACIONE TË TJERA

Ishujt urban të ngrohtësisë.

Lëvizjet e popullatave ndër shekuj nga një vend në një tjetër apo drejt qyteteve, kryesisht në funksion të një sërë faktorëve social ekonomike e politik apo dhe natyror mundësuan krijim e qyteteve gjithnjë e më të mëdha, të cilat si qendra të mëdha urbane përcollën dhe sollën dhe ndryshime të mjedisit e për rrjedhojë dhe të klimës.

Klima tashmë në këto hapësira nuk ishte si më parë, por u verifikuan rritje të temperaturave të ajrit, duke patur kësaj një modifikim të saj dhe relativisht të kufizuar në hapësira të caktuara.

Në mënyrë të veçantë në shekujt e fundit me krijimin e qyteteve të mëdha me popullsi shumë milionëshe duke patur sipërfaqe jo më me bimësi, por me ndërtime e rrugë si dhe industri të caktuara, është vrojtuar krijimi i ishujve urbanë të ngrohtësisë, të cilat karakterizohen nga ndryshime në ecurinë e temperaturës apo treguesve të tjerë meteorologjike, duke ofruar një klimë



relativisht të modifikuar, të ndryshme nga ajo e mëparshme dhe karakteristike për atë zonë. Në qytete të tilla si p.sh. Parisi, Londra, etj, janë vrojtuar ngritje të temperaturave me rreth 1-2°C ose dhe më shumë krahasuar me atë çka duhej të vrojtohej në kushte natyrore pa ndërtime, rrugë apo objekte të tjera industriale. (1*)

Gjatë periudhës së verës është i njohur fakti se zonat urbane janë të

predispozuar nga akumulimi i temperaturave shumë më të larta sesa zonat rurale, që njihet ndryshe edhe si efekti i ishujve të nxehtësisë. Kjo dukuri është pasojë e shumë faktorëve që janë karakteristike e një mjedisi urban, të cilët arrijnë të influencojnë dhe motin. Planifikimi urban ndikon në orientimin e erërave dhe në gjenerimin e turbulencave. Përveç kësaj, madhësia dhe forma e ndërtesave mund të ndikojnë në motin dhe në cilësinë e ajrit. Ndërtimet në shumicën dërmuese të rasteve, realizohen pa marrë parasysh se si mund të influencojnë në motin e një zone urbane.

Mirëpo, më shumë se gjysma e popullsisë së botës sot jeton në qytete, çka do të thotë se duhet t'i kushtohet një rëndësi më e veçantë faktit se si po ndryshon moti në zonat urbane në krahasim me ato periferike. Nisur nga kjo situatë së fundmi studiuesi D. Mauree paraqet një studim, i cili trajton modelet kompjuterike, që shërbejnë për llogaritjen e nxehtësisë së çliruar nga ndërtesat në motin lokal. Përfitimet kryesore të këtij hulumtimi konsistojnë në llogaritjen e saktë të bilancit energjetik të ndërtesave, që sjell gjithashtu dhe një shfrytëzim më të mirë të energjisë diellore, duke ulur konsumin e përgjithshëm të energjisë së një ndërtese, si dhe ndihmon në përcaktimin e shpërndarjes së ndotjes së ajrit në zonat urbane, gjë që ndikon drejtpërsëdrejti në shëndetin e popullsisë.

Përveç të tjerash me anë të këtij studimi meteorologët do të mund të përmirësojnë parashikimet e motit për qytetet, që gjithashtu do të sjellë edhe përmirësimin e mënyrës se si duhet të fillohet të planifikohet në ndërtimet në zonat urbane në vazhdim. (2*)

(1*) Petrit Zorba, pjesë e përshtatur për këtë buletin nga leksioni "Modifikimi i motit", Tiranë, IGJEUM, 2015;

(2*) Ben Sapsmon, "Urban Heat Wave" - Meteorological Technology Internacional, f.54-55, UK, April 2017, përkthyer e përshtatur për këtë buletin nga studentja e Ing. Mjedisit së UPT, Alda Popaj.

Për të lexuar buletinet e tjera jeni të mirëpritur të vizitoni faqen përkatëse, duke klikuar në link-un e IGJEUM-it.



<http://www.geo.edu.al>



☀ ☀ ☀
Ky “Buletin Mujor Klimatik” u përgatit nga
Departamenti i Klimës dhe Mjedisit të
IGJEUM-UPT.
Tiranë © 2017.

